



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2023

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8402, DATË 10.9.1998, “PËR
KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Neni 2, ndryshohet si më poshtë:

“Ky ligj zbatohet për të gjitha punimet e zbatimit, mbikëqyrjet dhe kolaudimet e punimeve të ndërtimit, që realizohen nga persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas projekteve të miratuara nga autoritetet përgjegjëse të zhvillimit të territorit.”

Neni 2

Në nenin 7/1, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në pikën “1”, pas togfjalëshit “Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë”, shtohet togfjalëshi “...dhe Sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (KKTU) për lejet e ndërtimit të lëshuara nga KKTU”.

b) në pikën “2”, togfjalëshi “...autoritetin përgjegjës së planifikimit” zëvendësohet me togfjalëshin “autoritetin përgjegjës së zhvillimit”.

Neni 3

Në Nenin 8, pika “6”, pas togfjalëshit “...Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, shtohet togfjalëshi “...dhe Sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit për lejet e ndërtimit të lëshuara nga KKTU”.

Neni 4

Në Nenin 9, paragrafi i parë zëvendësohet si më poshtë:

“Për të gjitha objektet e përkufizuara në pikën “1” të nenit 3 të këtij ligji, zbatuesi i punimeve, përpara fillimit të punimeve, duhet të njoftojë në seksionin e urbanistikës dhe Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit të bashkisë, si dhe Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, për lejet e ndërtimit të lëshuara nga KKTU.”

Neni 5

Pas Nenit 10, shtohet Neni 10/1, si më poshtë vijon:

“NENI 10/1

Sekretariati Teknik i KKTU kryen monitorimin e procesit të punimeve të ndërtimit, kryesisht, apo në rast se vihet në dijeni nga qytetarët, nga subjektet e përcaktuara në këtë ligj, ose nga inspektoriatet sipas legjislacionit për inspektimet, për shkelje të lejeve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, pasi të ketë vlerësuar situatën rast pas rasti, në varësi të kompleksitetit që mund të paraqesë projekti i miratuar nga KKTU.”.

Neni 6

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

a) në paragrafin e parë togfjalëshi “autoriteti vendor i zhvillimit të territorit” zëvendësohet me togfjalëshin “autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit”.

b) paragrafi i katërt ndryshohet si më poshtë:

“Agjencia Shtetërore e Kadastrës, kryen regjistrimin e objektit, në bazë të kërkesës së njësisë së qeverisjes vendore, apo Sekretariatit teknik të KKTU, sipas përgjegjësi në përputhje me

legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, për pronarët e truallit dhe subjektet, me të cilat zhvilluesi ka pasur aktmarrëveshje ose kontratë sipërmarrjeje.”.

c) paragrafi i pestë ndryshohet si më poshtë:

“Njësia e qeverisjes vendore apo Sekretariati teknik i KKTU, sipas përgjegjësive në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, janë të detyruar që të depozitojnë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës certifikatën e përdorimit brenda 60 ditëve nga lëshimi i saj.”

Neni 7

Në nenin 14/3 , bëhen këto shtesa:

a) në pikën “2”, pas fjalëve “*Inspektoriati Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit*”, shtohet togfjalëshi “*dhe Sekretariatin teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (KKTU) për lejet e ndërtimit të lëshuara nga KKTU*”.

b) në pikën “3”, pas fjalës “Bashkitë”, shtohet togfjalëshi “*dhe Sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit.*”

Neni 8

Kudo në përmbajtjen e këtij ligji, emërtimet e mëposhtme zëvendësohen si vijon:

- a) Togfjalëshi “Inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës/qarkut” zëvendësohet me togfjalëshin “Inspektoriati vendor i mbrojtjes së territorit të bashkisë”;
- b) Togfjalëshi “Autoriteti përgjegjës i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit” dhe “autoriteti përkatës i planifikimit” zëvendësohen me “Autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit”;
- c) Togfjalëshi “leja e përdorimit” zëvendësohet me togfjalëshin “certifikata e përdorimit”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA